

VENDIM
Nr. 52, datë 7.12.2022

PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN “PËR LICENCIMIN DHE USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË SHOQËRIVE TË KURSIM-KREDITIT DHE TË UNIONEVE TË TYRE”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, dhe të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar; dhe të nenit 60, pika 1 dhe nenit 69, pika 6 të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, “Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre”; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

VENDOSI:

1. Në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 104, datë 5.10.2016, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Në nenin 5 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 8, pas togfjalëshit “të nenit 6 të kësaj rregulloreje”, shtohet togfjalëshi “, si dhe të dokumentacionit të parashikuar në shkronjën “f”, nënpike “iii” ose në shkronjën “g”, nënpike “iii” të pikës 2, të nenit 6 të kësaj rregulloreje”;

ii. pas pikës 8, shtohet pika 8/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

“8/1. SHKK-ja, për çdo pagesë dhe/ose shtesë të kapitalit nga kontributet individuale të çdo anëtari dhe/ose fondet e donatorëve nën vlerën 100,000 lekë, siguron dhe mban në dosje të veçanta dokumentacionin e parashikuar në shkronjën “f”, nënpike “iii” ose në shkronjën “g”, nënpike “iii” të pikës 2, të nenit 6 të kësaj rregulloreje.”;

b) Në nenin 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i. në pikën 2, shkronja “f”, pas nënpikës “ii”, shtohet nënpika “iii” me përmbajtjen e mëposhtme:

“iii. vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente, që certifikojnë se:

- personi nuk është në ndjekje penale;
- personi nuk është në gjykim për vepra penale;
- personi nuk është i dënuar penalisht (nga Ministria e Drejtësisë);
- personi nuk është objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm (nga Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor).

Dokumentet e lartpërmendura në nënpikën “iii”, të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë”;

ii. në pikën 2, shkronja “g”, pas nënpikës “ii” shtohet nënpika “iii” me përmbajtjen e mëposhtme:

“iii. vërtetimet e mëposhtme të lëshuara nga organet kompetente, që certifikojnë se:

- personi nuk është në ndjekje penale;
- personi nuk është në gjykim për vepra penale;
- personi nuk është i dënuar penalisht (nga Ministria e Drejtësisë);
- personi nuk është objekt i procedurave të ekzekutimit të detyrueshëm (nga Zyra e Përmbarrimit Gjyqësor).

Dokumentet e lartpërmendura në nënpikën “iii”, të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së aplikimit në Bankën e Shqipërisë”;

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR

Gent Sejko